



Datë: 03.09.2025
Numër Protokolli: 5942/2025

A.nr.787/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.787/2025, të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja M.K kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.787/2025, të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja, M.K.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil M.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 30.04.2025 përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar më datë 02.05.2025, kundër, Njoftimit për kandidatin fitues me numër protokolli Nr. 1281, të datës 03.04.2025 në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016448, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Diagnostifikimin e Patogjenëve në Ushqime, të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit, më datë 21.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.787/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 23.01.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016448, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Diagnostifikimin e Patogjeneve në Ushqime, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend i lirë pune, në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, i hapur për aplikim nga data 24.01.2025 deri më datën 22.02.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (28) kandidatë, ndër ta edhe ankuesja, e cila ë bashku me 11 kandidatë tjerë ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, dhe se i njëjta i është nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim ka mbledhur 43.4 pikë, si pikë të pa mjaftueshme për të vazhduar me fazën e vlerësimit të intervistës me gojë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 03.04.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokoli Nr.1281, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë të suksesshëm për procedurën përkatëse është shpallur B.K me 91.2 pikë.

Pas, publikimit të Njoftimit me numër protokoli Nr.1281, të datës 03.04.2025, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar vlerësimin përfundimtar të procesit të rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00016448, për shkak të shkeljes së Ligjit material, nën supozimin se kandidati i suksesshëm është përzgjedhur në bazë të preferencave politike, e gjithashtu i njëjti sipas ankueses testin me shkrim e ka përfunduar për 10 minuta, shton se është informuar nga anëtari i komisionit se minutazhi i testit me shkrim për kandidatin fitues figuron të jetë 35-38 minuta, ku e njëjta ka dyshime se ka pasur ndërhyrje edhe në sistem. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procesin e rekrutimit në tersi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidatja V.H, si kandidatë në procedurën e njëjtë, ka parashtruar ankesë me numër A.nr.758/2025 duke kontestuar procedurën me numër reference RN00016448, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.787/2025, të datës 01.09.2025, procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016448, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Diagnostifikimin e Patogjenëve në Ushqime, të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.787/2025, të datës 02.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.758/2025, të datës 29.04.2025, rrjedhimisht, ka anuluar Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.787/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.787/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.K;
- Udhëheqësit të Personelit në MBPZHR; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.